



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Doretuar Prilmenoi/Prodato Received/Delivered	16.05.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SK/KM/SHCK	11264/2023		115



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.500/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.500/2023 të datës 15.03.2023 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_, kundër organit të punësimit Presidencë e Kosovës, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 16.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** si e bazuar ankesa me numër A.nr.500/2023, e datës 15.03.2023, e parashtruar nga ankuesi
- II. **Shfuqizohet** Vendimi me numër nr.12/2023 i datës 13.03.2023 i zyrës së personelit në Presidencën e Kosovës, ndërsa **Anulohet** konkursi i datës 31.01.2023 sipas numrit të referencës RN00010895 për Ngritje (avancim) në detyrë për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Teknologji Informativë" të shpallur nga Presidencë e Kosovës.
- III. **Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Personelit në Presidencën e Kosovës që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore me qëllim të zbatimit të këtij vendimi në afat prej pesëmbëdhjetë 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Presidenca e Kosovës duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë neni 39 (1,2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës me datë 31.01.2023 ka bërë njoftimin për konkursin me numër të referencës RN00010895 për Ngritje (avancim) në detyrë për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Teknologji Informative" të shpallur nga Presidenca e Kosovës. Në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi.

Menaxherja e Personelit në Presidencën e Kosovës me datën 28.02.2023 ka nxjerr vendimin për mosplotësimin e kushteve për aplikim me numër Nr.10/2023 sipas të cilit ankuesi nuk i plotëson kushtet e kërkuara dhe rrjedhimisht nuk ka të drejtë të vazhdojë më tej konkurimin.

Kundër vendimit me numër Nr.10/2023 të datës 28.02.2023 ankuesi ka parashtruar ankesë në Divizionin për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Presidencën e Kosovës. Ndërsa Divizionin për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me datë 13.03.2023 me numër Nr.12/2023 ankuesit i ka refuzuar ankesën lidhur me mos përfshirjen në listën e ngushtë për Ngritje (avancim) në detyrë për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Teknologji Informative" të shpallur nga Presidenca e Kosovës.

Ankuesit kundër vendimit të Divizionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me numër Nr.12/2023 të datës 13.03.2023, me datë 15.03.2023 me numër protokollit 2674/2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendimin ankimor për shkak të shkeljeve të parimeve apo rregullave të shërbimit civil si dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.04.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Presidenca e Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 25.04.2023 me numër protokollit 3793/2023 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Presidenca e Kosovës, me shkresat e bashkangjitura.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me numër VK/2023 me datë 26.04.2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me nr.protokollit 2674/2023 të datës 15.03.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i Divizionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me numër Nr.12/2023 të datës 13.03.2023; Ankesë e ankuesit drejtuar Divizionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Presidencën e Kosovës i datës 08.03.2023; Vendim i Divizionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me numër Nr.10/2023 i datës 28.02.2023; Akt Emërim i . . . i datës 01.07.2019; Diplomë e . . . nga Kolegji Iliria me numër nr.453/14 i datës 23.03.2015; Certifikatë nga Cisco për . . . i datës 05.04.2009; Shkresë nga Cisco për . . . i datës 25.01.2010; Certifikatë nga Cisco për . . . i datës 25.01.2010; Certifikatë nga Cisco për . . . i datës 28.04.2010; Shkresë nga Cisco për . . . i datës 28.04.2010; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokollit 3368/2023 i datës 06.04.2023; Përgjigje në ankesë me numër protokollit 3793/2023;

Aplikacioni i ... i datës 21.02.2023; Diplomë e shkollës së mesme e ... me numër protokollit 2337 i datës 18.06.2008; Aneks i kontratës nga shoqëria "Ardi dhe Co" sh.p.k. për ... i datës 24.04.2013; Kontratë për themelimin e marrdhënies së punës nga "Ardi dhe Co" sh.p.k. për ... i datës 24.01.2013; Kontratë pune për kohë të caktuar nga trainkos për A.S. i datës 02.12.2016; Letërnjoftim i ...; Letër referenc nga Innovation për ... i datës 28.10.2011; Letër referenc nga KQZ për ... e vitit 2021; Letër referenc për ... i datës 31.10.2013; Vendim nga Sekretari i zyrës së Presidentit për ... me numër protokollit 85 i datës 27.01.2020; Vërtetim nga Menaxherja e Personelit zyra e Presidentes për ... i datës 15.02.2023; Certifikatë mbi dënimet penale për ... i datës 15.02.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për ... i datës 27.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për ... i datës 31.01.2023; Konkurs Lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Teknologji Informativë" të shpallur nga Presidenca e Kosovës i datës 13.12.2022; Rregullore (QRK) Nr. 10/2022 për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil; Konkurs Lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informativë dhe shërbime logjistike" të shpallur nga MFPT i datës 08.02.2023; Vendim i U.d. Sekretarit të zyrës së Presidentes me numër Nr.192/2022 i datës 30.11.2022; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën "Administrator i Lartë i TI-së për Sisteme"; Njoftim nga Udhëheqësja e Divizionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me numër Nr.13.2023 i datës 24.03.2023; Konkurs për Ngritje (avancim) në detyrë për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Teknologji Informativë" të shpallur nga Presidenca e Kosovës i datës 31.01.2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit ... është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar të gjitha provat e lëndës dhe ka konstatuar se kriteret e konkursit për Ngritje (avancim) në detyrë për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Teknologji Informativë" të shpallur nga Presidenca e Kosovës të datës 31.01.2023, kërkesat e përgjithshme formale kanë qenë:

- Diplomë Universitare e nivelit master në fushën e Teknologjisë Informativë (TI);
- Kualifikime të posaçme formale për IT dhe Certifikatat profesionale përkatëse;
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale.

Ndërsa Kolegji i Këshillit, bazuar në provat e lëndës ka gjetur se ankuesi me rastin e aplikimit për këtë pozitë si dëshmi të përgatitjes së arsimimit të kërkuar ka dërguar: Diplomën e studimeve themelore universitare me numër nr.453/14 të datës 23.03.2015 sipas të cilës dëshmohet se i njëjti i ka përfunduar studimet në Kolegjin Iliria në programin Shkenca Kompjuterike dhe Teknologji Informativë e Aplikuar dhe ka marrë gradën Bachelor (BSc) në Shkenca Kompjuterike dhe Teknologji Informativë e Aplikuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së shpalljes së konkursit dhe zhvillimit të procedurave të rekrutimit deri në fazën kur ankuesi ka parashtruar ankesë, ka analizuar dispozitat e Rregullores (QRK) 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, konkretisht tek shtojca Shtojca Nr.1/5: Përshkrimi i

përgjithshëm i punës për klasën Drejtues i Ultë përcakton se *Drejtues i Ultë Në këtë klasë vendoset Udhëheqësi i një Divizioni i cili është përgjegjës për fushën e caktuar të përgjegjësisë brenda Departamentit ose institucionit. Mbajtësi i kësaj pozite është nëpunës civil i cili për punën e tij i përgjigjet drejtpërdrejtë Drejtorit të Departamentit ose udhëheqësit më të lartë administrativ.* Përfshin pozitat me këto emërtesa: 1. Udhëheqës i Divizionit në Presidencë; 2. Udhëheqës i Divizionit në Zyrën e Kryeministrit; 3. Udhëheqës i Divizionit në një Ministri; 4. Udhëheqës i Divizionit në një Institucion Kushtetues të Pavarur; 5. Udhëheqës i Divizionit në Agjenci të Pavarur dhe në Agjenci Rregullatore. 6. Udhëheqës i Divizionit/Sektorit në Agjenci Ekzekutive, Komunë dhe Institucion të Administratës së Shërbimeve Publike. Ndërsa tek pika IV Kërkesat e përgjithshme formale: a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve. b) Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase. c) Përvoja e punës e kërkuar: Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale. Kolegji i Këshillit ka konstatuar se tek kërkesat e përgjithshme formale sipas kushteve të konkursit për Ngritje (avancim) në detyrë për pozitën *“Udhëheqës i Sektorit për Teknologji Informativë”* të shpallur nga Presidenca e Kosovës i datës 31.01.2023 sipas numrit të Referencës RN00010895 është përcaktuar *Diplomë Universitare e nivelit master në fushën e Teknologjisë Informativë (TI).* Andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se me rastin e ndryshimit të kriterëve të konkursit për Ngritje (avancim) në detyrë për pozitën *“Udhëheqës i Sektorit për Teknologji Informativë”* të shpallur nga Presidenca e Kosovës i datës 31.01.2023 respektivisht mos përfshirja e kriterit *Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve* siç përcaktohet me dispozitat e kësaj rregulloreje, Presidenca e Kosovës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik neni 6 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: 1. *Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativoteknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve.* 2. *Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive”,* si dhe në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 4 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *Parimet e pranimit dhe avancimit në karrierë: 1. Pranimi dhe avancimi në karrierë në shërbimin civil bazohet në parimet e mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë e proporcional gjinor dhe të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë.* 2. *Nëpunësit civil pranohen dhe avancohen në karrierë në bazë të meritës të vlerësuar në bazë të një procedure konkurruese dhe transparente, të përcaktuar në bazë të Ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore.*

Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë si dhe analizimit të dispozitave ligjore lidhur me kushtet dhe kriteret në shërbimin civil, duke marrë për bazë edhe konstatimet e pasqyruara si në arsyetimin e këtij vendimi, ka konstatuar se konkursi për Ngritje (avancim) në detyrë për pozitën *“Udhëheqës i Sektorit për Teknologji Informativë”* të shpallur nga Presidenca e Kosovës të datës 31.01.2023 sipas numrit të Referencës RN00010895 është bërë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 2 të Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: 2. *Nëpunësit civil pranohen dhe avancohen në karrierë në bazë të meritës të vlerësuar në bazë të një procedure konkurruese dhe transparente, të përcaktuar në bazë të Ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore,* si dhe në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: 1. *Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativoteknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta,*




meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive, dhe mbi këtë bazë ka vendosur të anulojë konkursin e lartcekur si dhe të shfuqizojë çdo akt tjetër administrativ që rrjedh nga kjo procedurë e rekrutimit, ndërsa ankesa e ankuesit është aprovuar mbi bazën e kësaj të gjeture të cilën edhe vetë pala e ka atakuar, respektivisht Kolegji i Këshillit nuk është lëshuar më tej në shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, pasi që shpallja e konkursit nuk ka qenë në harmoni të plotë me dispozitat e akteve ligjore të përcaktuara si më lartë dhe ka vendosur që të njëjtën procedurë ta anulojë tërësi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.500/2023.**

Çlirim Zeka  
  
Procesmbajtës

  
Eshref Shabani  
  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Presidencën e Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Presidencën e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.